



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°32/2022

Hagë, 08/09/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 1 shtator, Gjykatësit të Procedurës Paraprake iu dorëzua Raporti i Tretë i Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces në çështjen kundër Pjetër Shalës. Raporti i përcjell Gjykatësit të Procedurës Paraprake gjashtë kërkesa për statusin e viktimës pjesëmarrëse në proces si dhe përmban rekomandime mbi pranueshmërinë, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse. Aktualisht, janë pranuar dy viktima të marrin pjesë në këtë çështje gjyqësore.

Procesi i parashtrimit të kërkesave të viktimave për pjesëmarrje është ende i hapur në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës dhe në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Personat që mund të demonstrojnë se kanë pësuar personalisht dëm fizik, mendor ose material si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përfshirë në një aktakuzë të konfirmuar nga DHSK-ja, mund të paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në proces.

Më shumë informacion rreth pjesëmarrjes së viktimave, përfshirë mënyrën sesi mund të parashtrihen kërkesat, mund të gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në shqipe, serbishte dhe anglishte.

Më 2 shtator, Prokuroria në çështjen kundër Thaçit dhe të bashkakuarve dorëzoi listën e rishikuar të dëshmitarëve, pas urdhrit me gojë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake drejtuar Prokurorisë për thjeshtimin e mëtejshëm të çështjes së saj. Lista përfshin informacion të përditësuar për kohën që parashikohet të nevojitet për marrjen në pyetje të secilit dëshmitar.





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°32/2022

Hagë, 08/09/2022

Sot, në orën 13:30, nisi konferenca e katërmbëdhjetë mbi ecurinë e kësaj çështjeje, të cilën publiku mund ta ndjekë nga galeria publike në Dhomat e Specializuara të Kosovës ose nëpërmjet internetit, ku transmetohet me 45 minuta vonesë. Parashtrimet me shkrim të palëve për këtë konferencë mund të gjenden në faqen tonë të internetit.

Konferencat mbi ecurinë e çështjes mbahen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të mundësuar përgatitje të shpejtë të çështjes për gjykim si dhe për të garantuar se përgatitjet po kryhen në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

Më 2 shtator, një version i redaktuar më tej i dosjes së apelit të Nasim Haradinajt u riklasifikua nga konfidencial në publik. Dosjet e apelit të Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt tashmë mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së. Sipas Rregullores, këto dosje duhet të përfshijnë argumentet e Mbrojtjes kundër aktgjyimit dhe dënimit dhe Prokuroria ka 30 ditë për të dorëzuar përgjigjen me shkrim.

Në gjykimin e Salih Mustafës, deklaratat përmbyllëse janë planifikuar të fillojnë javën e ardhshme, duke filluar nga e marta, 13 shtator, në orën 09:30.

Programi, i cili mund ketë edhe ndryshime, planifikon që deklarata përmbyllëse e Prokurorisë të mbahet më 13 shtator, e ndjekur nga deklaratat e mbrojtëses së viktimave dhe të Mbrojtjes më 14 shtator. Përgjigjet, pyetjet nga Trupi Gjykses dhe deklaratat e të dyja palëve mbi zhdëmtimin janë planifikuar për datën 15 shtator.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

